



**NGRITJA
E ZËRIT**

Tel: 044 195-113
044 633-325
Adresa: Rruga e UÇK-së,
Skenderaj
Email: info@ngritjaezerit.org
Web: www.ngritjaezerit.org

GJYKATES KOMUNALE NE SKENDERAJ

PADITES: Afrim Aruqaj nga fshati Rezallë , 41000 Skenderaj, Republika e Kosovës

E PADITUR: REPUBLIKA E SERBISË – Qeveria e R.S. rr. e Nemanjës nr.11 11000 Beograd

PADI PER KOMPENZIM DEMI

Propozim për lirimin nga pagimi i shpenzimeve procedurale (sipas nenit 7 te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006)

Objekt kontesti : Kompensimi dëmit

Vlera e kontestit : 623.500 €

- 1.) Paditësi Afrim Aruqaj me datën 20 mars 1999 është arrestur nga forcat serbe në Skenderaj , pas disa orëve është dërguar , në burgun e Mitrovicës ne te cilin ka qëndruar deri me 20 qershor te vitit 1999, pastaj është transferur në Pozharevcë , për tu gjykuar e nga këtu në Krlevë, pas përfundimit të gjykimit e kanë transferuar në Pozharevcë për ta vazhduar mbajtjen e burgut deri me datën 22. mars 2000, kur edhe kryen mbajtjen e dënimit te shqiptuar me par.
- 2.) Paditësi së bashku me 10 anëtarët të familjes për t'ju shmang rrezikut nga forcat serbe është detyruar ta braktisi shtëpinë me dt. 11.09.1998 duke qëndruar neper vendqëndrime te ndryshme si ne: Qirez dy ditë prej aty në Reznik 4 ditë , pastaj në Mitrovicë e në Shipol 21 ditë . Me dt. 2 tetor 1998 deri me 20 mars të vitit 1999 kanë qëndruar në Skenderaj , prej 20 marsit policia , ushtria dhe paramilitaret i kan qitur prej shtepie duke e bere ndarjen e familjes , grat i kan vendosur në qender të Skenderajt , kurse burrat në fabriken e municionit ndersa paditësin e kan derguar në burgun e lartcekur, ndërsa familja nga data 24 mars te vitit 1999 ka qëndruar në Mitrovicë deri me 15 prill , me 16 prill dhunshme nga ana e forcave serbe detyrohet te futet ne kolon ne drejtim për ne Republikën e Shqipërisë dhe janë vendosur në Skrap deri me 4 gushtë te njëjt vit 1999, kurse me 4 gushtë janë kthyer në Kosovë , dhe jan vendosur në në Skenederaj në shtepin e kusheririt Hajzer Aliu deri në vitin 2002 .
- 3.) Paditësi ka psuar deme ngase ju ka djegur shtëpia me sipërfaqe prej 75 m² , dëmtim te kategorisë se IV , oda me sipërfaqe prej 72 m² e djegur , dëmtim te kategorisë se IV , interier shtëpiak duke e përfshire tekniken e bardhe me pajisjet përkatëse në sallon dhe mobilierin e dhomave te gjumit të djegura , dyert e

oborrit të shkatrruara , shtallën 8 metra me 5 metra e djegur , ka humbur 50 cop pula .

- Provë : - Kërkesa për kompensimin e dëmeve të luftës , e dt.12.01.09 , nr. 580 – 3
- Deklarata për bashkësinë familjare 035/481 e dt. 20.01.2009
 - Vërtetimi i Drejtorisë së Urbanizimit nr.325-132 i dt.05.01.2009
 - Certifikata mbi të drejtat e pronë së palujtshme UL 72015061-00173 , e dt. 1/5/2009
 - Vërtetimi i Sh.B.P. , nr. 23/9, dt. 29.12.2008
 - Aktvendimin mbi vazhdimin e paraburgimit K.82/99 , dt.27.01.2000
 - Aktakuza KT .6p. 8/99 , dt. 26.03.1999

4.) Babait të paditësit Rrahimit i është ndaluar pensioni që nga muaji dhjetor i vitit 1998 e deri me sot .

Provë : Dëshmia mbi pagesën e pensionit për muajin dhjetor 1998 e Rrahim Aruqit

Dëgjimi i paditësit anëtarëve tjerë të familjës dhe provave të tjera të cilat paditësi do të prezantojë në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në rast nevojë të caktohet edhe eksperti përkatës.

4.) Të drejtën për kompensim paditësi e bazon në nenin 185 të LMD (G. Z. e RSFJ , Nr. 29 /78) në lidhje me nenin 180.1 të të njëjtit Ligj , me të cilin është paraparë që për demin e shkaktuar ndaj pasurisë të personave fizikë si rezultat i dhunës dhe terrorit , përgjegjëse është „ Bashkia shoqërore politike ” e në këtë rast e paditura ka qenë e obliguar të pengojë aktet e vrasjes , dhunës , terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes së pasurisë së paditëses .

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (neni 1 Protokollin nr. 1 , neni 2 dhe protokollin nr. 6 , neni 3 , neni 5 (5) , neni 10 dhe neni 14) .

Paditësi propozon që kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor të çështjes , t'i shfrytëzojë informatat e dhura nga mjetet provuese të propozuara dhe

1.) pastaj të bjen këtë :

AKTGJYKIM

I. Aprovohet kërkesa paditësit Afrim Aruqaj nga fshati Rezallë, 41000 Skenderajt Republika e Kosovës në tërësi si e bazuar .

II. Obligohet e paditura Republika e Serbisë, - Qeveria e Serbisë si pasardhëse juridike e Qeverisë së mëparshme që në emër të të njëjtës të kompensojë demin material dhe jo material paditësit Afrim Aruqaj nga fshati Rezallë, 41000 Skenderajt Republika e Kosovës, duke ja paguar :

- shumën prej 200 000 € për të qëndruarit në burg
- shumën prej 216 000 € për dhembjen shpirtërore dhe të munduarit , ndjekjes nga shtëpia , banimi në qiell të hapur dhe shtëpi të huaja
- shumën prej 50 000 € për shkak të pamundësuarit e krenimit të festave fetare në shtëpi, vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes së kontaktit me farefis dhe të afërmit
- shumën prej 152000 € për shtëpinë , oden dhe ahurin e djegur dhe të shkatërruar,
- shumën prej 5000 € për interierin shtëpiak .
- shumën prej 500€ për shpezë
- shumën prej ----- € për mos pagesën e pensionit për babain

te gjitha këto shuma me kamat ligjore qe nga dita e ngritjes se padisë e deri ne ditën e pagesës definitive të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit , nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .


Pala e paditur te paguaj shpenzimet procedurale te kësaj çështje juridike në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit, nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .

1.) të bihet :

AKTVENDIM

Mbi miratimin e propozimit te paditëses në ter çështjen juridike mbi lirimin nga pagimi i taksave dhe shpenzimeve tjera procedurale duke marr parasysh gjendjen e vështir ekonomike te paditëses ne kuptim me nenin te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006 .

Skenderaj , me dt. 03.05.2010

Paditësi ,
Afrim Aruqaj


Shtojcë :

1. Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës , e dt.12.01.09, nr. 580 – 36
2. Vërtetimet e D.U.M.A. 325 – 132 , dt. 05.01.2009
3. Vërtetimet e Sh.B.P. , nr. 23/9, dt. 29.12..2009
4. Deklarata për bashkësinë familjare 035/481 e dt. 20.01.2009
5. Aktvendimin mbi vazhdimin e paraburgmit K.82/99 , dt.27.01.2000
6. Aktakuza KT ,6p. 8/99 , dt. 26.03.1999
7. 4 kopje te padisë